



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:077082
Datë: 11.08.2023
Numri i dokumentit: 04578506
C.nr.1577/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Liridona Haziri-Mustafa, me bashkëpunëtoren profesionale V. A., në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. K. me vendbanim në F., Rr. "D. Gj. L.", nr.4, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H. J., avokat nga Gj., kundër të paditurës K. e S. "I.", me adresë në P., Rr. "P. V.", nr.4, me objekt kontesti kompensim dëmi material, me vlerë kontesti 25,000.00 euro, jashtë seance gjyqësore, me datë 04.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të likuidimit të të paditurës "I.", me seli në P., Rr. "P. V.", nr.4.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 29.06.2020, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit, me objekt kontesti kompensim dëmi material.

Duke qenë se në këtë procedurë, si palë e paditur është paraqitur kompania e sigurimeve "I." me seli në P., gjykata nga shënimet zyrtare në Bankën Qëndrore të Kosovës-BQK, është njoftuar lidhur me statusin e të paditurës së lartëcekur dhe procedurat eventuale ligjore të cilat janë zhvilluar në lidhje me të. Është konstatuar se me datë 26.04.2019 nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së është marrë vendim që Kompanisë së Sigurimit "I." SH.A., D. K., t'i revokohet Licenca nr... e datës 25 mars 2002, e lëshuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK), paraardhëse ligjore e BQK-së, dhe pasi që e njëjta gjendet në proces të likuidimit, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke pasur parasysh dispozitën ligjore të nenit 227 pika d), të LPK-së, ku shprehimisht përcaktohet se "*kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues*".

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 142 të LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.1577/2020, me datë 04.08.2023

Gjyqtarja
Liridona Haziri-Mustafa

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kesaj gjykate.